



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
KËSHILLI I BASHKISË SË QYTETIT
KORÇË
VENDIM

Nr 76 Datë 15.10.07

PËR

NDRYSHIMIN E STRUKTURËS NË ADMINISTRATËN E
BASHKISË

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, i mbledhur në datën e sotme, mbasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Financës, "PËR NDRYSHIMIN E STRUKTURËS NË ADMINISTRATËN E BASHKISË", bazuar në ligjin nr. 9723 dt.03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" neni 11, ligjin nr. 9780 dt. 16.07.2007 "Për inspektimin e ndërtimit", ligjin nr 8652 dt. 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", neni 12, neni 32 pika "ç", ligjin nr 8379 dt. 09.09.1998 "Për buxhetin lokal", Ligji nr 9645 dt. 27.11.2006 "Për buxhetin e shtetit të vitit 2007", V.K.M. nr. 434 dt. 13.07.2007 "Për disa ndryshime në V.K.M. nr. 551 dt. 07.11.2002, "Për klasifikimin e funksioneve dhe grupimin e njësive të Qeverisjes Vendore, për efekt page, e përcaktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të Qeverisjes Vendore", të ndryshuar". Udhëzimin nr 2 dt. 17.01.2007 i M.F. "Për zbatimin e buxhetit të shtetit për vitin 2007", Udhëzimin nr 353 dt.19.03.2007 të Ministrisë së Brendshme "Për zbatimin e Buxhetit të Qeverisjes Vendore për vitin 2007", V.K.B. nr 3 dt. 02.02.2007 "Për miratimin e strukturës dhe pagave të administratës së Bashkisë dhe institucioneve të vartësisë për vitin 2007", si dhe V.K.B. nr. 2 dt. 02.02.2007 "Mbi miratimin e buxhetit të Bashkisë dhe institucioneve të vartësisë për vitin 2007", mbështetur në kompetencat që ka si dhe mbas diskutimit të anëtarëve:

VENDOSI

1. Të miratojë ndryshimin e strukturës të administratës, duke shtuar 5 punonjës si me poshtë:

- | | |
|---|--------|
| • Kryeinspektor i inspektoriatit të ndërtimit | 1(një) |
| • Specialist i nivelit të lartë në inspektoriatin e ndërtimit | 2(dy) |
| • Specialist i nivelit të lartë pranë Q.K.R. (Korce) | 2(dy) |

2. Niveli i pagave për këtë shtesë në strukturën administrative do të jetë si më poshtë:

Emertimi	Nr i punonjesve	Kategoria	Paga e grupit	Shtese per vjetërsi	Shtesë për pozicion
Kryeinspektor	1	IIb	10050	2%	40.000
Inspektore	2	III b	10.050	2 %	25.124
Specialist i nivelit te larte per QKR	2	III b	10.050	2 %	25.124

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Personelit, Protokoll-Arkivës dhe Mbështetjes ne Bashki.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetare e Këshillit

Raimonda NASE
Raimonda NASE